



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT

Departamenti i Prokurimit

Komuna e Lipjanit: datë, 13/04/2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 12/04/2022 të parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik CAPITAL X FET SH.P.K.; ROSI TRADE SH.P.K. me seli në Klinë, Kosovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: Mirëmbajtja dhe pastrimi i objekteve Komunale. me numër identifikues: **613-21-1384-2-2-1 Nr i brendshëm 613 022 025 221.**

VENDIM

Refuzohet kërkesa për rishqyrtim, e parashtruar Grupi Operatorëve Grup i Operatorëve Ekonomik CAPITAL X FET SH.P.K.; ROSI TRADE SH.P.K. me seli në Klinë, Kosovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: Mirëmbajtja dhe pastrimi i objekteve Komunale me numër identifikues: **613-21-1384-2-2-1, Nr i brendshëm: 613 022 025 221**

Vërtetohet Vendimi i AK për anulimin e aktivitetit të prokurimit, të publikuar me datë: **06/04/2022.**

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Grupi Operatorëve ekonomik Grup i Operatorëve Ekonomik CAPITAL X FET SH.P.K.; ROSI TRADE SH.P.K. me seli në Klinë, Kosovë., më datë 11/04/2022: ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim për tenderin me titull: "Mirëmbajtja dhe pastrimi i objekteve Komunale me numër identifikues: **613-21-1384-2-2-1, Nr i 613 022 025 221**, Autoriteti Kontraktues, me datë 13/04/2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimet e ankuesit janë të pa bazuar :

Gjatë vlerësimit komisioni vlerësues ka konstatuar se te përshkrimi i çmimit është një gabim te kolona e fundit: **Shuma totale me TVSH për 36 muaj ndërsa është dashtë të jetë : Shuma totale me TVSH për 1 muaj kështu që kjo ka krijuar konfuzion te shumë tenderues dhe disa në këtë kolonë kanë vendosë çmimin për 36 muaj e pastaj e kanë pjesëtua për të nxjerrë shumën për një muaj.**

Nr. I art	Përshkrimi i objekteve që do të mirëmbahen	Njësia	Sasia	Çmimi me TSVH për njësi për 1 muaj	Shuma Totale me TVSH për 36 muaj
-----------	--	--------	-------	------------------------------------	----------------------------------

1	Ndërtesa e Komunës	m ²	5000		
2	Qendra për punë sociale	m ²	340		
3	Salla e kinofilmit e cila gjendet në shtëpia e kulturës "Tahir Sinani"	m ²	550		
4	Arkivi Historik i Qytetit të Lipjanit	m ²	1350		
5	Oborri i Komunës	m ²	1200		
6	Zyret e vendit të gjendjes Civile në disa loka Shalë 64 m ² , Janjevë 28 m ² , Gadime 77 m ² , Kraishtë 44 m ² , Magure 1= 35 m ² , Magurë 2 = 25 m ²	m ²	273		
Shuma e përgjithshme për një muaj					
Gjithsej shuma (për 36 muaj)					

Oferta e juaj është me gabim aritmetikor nën vlerën e lexuar për 2929.77% sepse pas llogaritjes aritmetikore shuma e përgjithshme e ofertës tuaj për 36 muaj është 3,564.87€, ndërsa shuma e shërbimeve që ka kërkuar Autoriteti kontraktues në bazë të çmimeve njësi që ju i keni ofruar do të ishte 80.06€, nuk qëndron pohimi i juaj se ju e keni bërë kalkuluar mirë sepse siç u cekë më lartë në tabelë shkruan Shuma Totale me TVSH për 36 muaj e jo siç keni deklaruar në kërkesë për rishqyrtim sepse duhet të vepohet vetëm sipas asaj që është shkruar e jo sipas asaj që mendojmë ne apo kushdo tjetër se është e drejtë, për këtë shih tabelën pas llogaritjes aritmetikore nga komisioni vlersues.

Nr. i art	Përshkrimi i objekteve që do të mirëmbahen	Njësia	Sasia	Çmimi me TVSH per njësi për 1 muaj	Shuma Totale me TVSH për 36 muaj
1	Ndërtesa e Komunës	m ²	5000	0.34	1700
2	Qendra për punë sociale	m ²	340	0.34	115.6
3	Salla e kinofilmit e cila gjendet në shtëpia e kulturës "Tahir Sinani"	m ²	550	0.33	181.5
4	Arkivi Historik i Qytetit të Lipjanit	m ²	1350	0.30	405
5	Oborri i Komunës	m ²	1200	0.30	360.00
6	Zyret e vendit të gjendjes Civile në disa lokalitet si: Shalë 64 m ² , Janjevë 28 m ² , Gadime 77 m ² , Kraishtë 44 m ² , Magure 1= 35 m ² , Magure 2 = 25 m ²	m ²	273	0.44	120.12
Shuma e përgjithshme për një muaj					80.06
Gjithsej shuma (për 36 muaj)					2882.22

Nr. i	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Shuma me TVSH për 1 sezonë	Shuma me TVSH për 3 sezona
1	Mbjellja e fidanceve-luleve	copë	1500	15	45.00
	Shuma e përgjithëshme				45.00

Nr.	Përshkrimi	Shuma totale me TVSH
1	Tabela I	2882.22
2	Tabela II	682.65
	Shuma e përgjithëshme me TVSH	3564.87

Pra tek shuma totale me TVSH për 36 muaj ju keni kalkuluar me shumë prej 2882.22€, kështu që duke i pare këto defekte në përshkrimin të çmimeve komisioni vlerësues ka rekomanduar për anulim të kësaj procedure.

Andaj duke u bazuar nga ajo që u tha më lartë Zyrtari Përgjegjës i prokurimit ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Bekim Shabani

 Drejtor i drejtorisë së Prokurimit